

UDHËZIM
Nr. 2, datë 18.7.2025

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 5628, DATË 18.11.2016, “PËR MIRATIMIN E RRJETIT TË LINJAVE NDËRQYTETËSE”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 9, 16 dhe 19, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3, pika 4 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“4. Pika e nisjes (vendi i nisjes) dhe pika e mbërritjes (vendi i mbërritjes) është qyteti qendër bashkie dhe/ose qyteti që është në përbërje të bashkisë dhe/ose destinacione turistike, porte dhe/ose aeroporte.”

Neni 2

Në nenin 5, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Itineraret, të cilat lidhin portet dhe aeroportet me çdo bashki për efekt të rëndësisë kombëtare, janë linja ndërqytetëse.”

Neni 3

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKYEMINISTËR DHE MINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku